

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi"/ Vajza e Jakup Krasniqit për T op Channel: Ja mesazhi që na ka lënë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/nje-njeri-i-zakonshem-nuk-mund-ta-kete-ate-buzeqeshje-pas-atij-vendimi-per-lotet-vajza-e-jakup-krasniqit-ja-mesazhi-qe-na-ka-lene/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:07:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 12:04:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 12:03:00 UTC → 17 shtator 2026, 12:05:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cab622414fbe779bec2cda321b25188674d051d94255f1e93e75e6854b94bd06
TEKSTI	230f29b8dccc2d2624e34f198509f32d808ecf38a690a3d5ae676984cda5ef87
PAMJA	7e15e3473e9548dc9bece7859104d6bb10bbd59e522af3450288e6eaad51ed0b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fd4046b13633944684374117d3ea330a784fd4961d556a7a11150c00eed5f59e
E MËPARSHMJA	936962392078c3192e276b24a4c61c7782c6031f4891da0cd24fe4a9836018d7
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fd4046b13633944684374117d3ea330a784fd4961d556a7a11150c00eed5f59e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA DHE RAJONI KRYESORE TË FUNDIT

"Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi" / Vajza e Jakup Krasniqit për Top Channel: Ja mesazhi që na ka lënë

17/09/2026 14:04



Vajza e Jakup Krasniqit, Gresa, foli ekskluzivisht për Top Channel pas vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës për liderët e UÇK-së.

Në një intervistë me gazetaren Kristi Gongo, Gresa Krasniqi shprehet se Gjykata Speciale është 'gatuar' në Beograd dhe se i ati i saj ka qenë gjithmonë kundër, gjë që sipas saj ka ndikuar dhe në masën e ashpër.

"Shpresonim që do ishte një vendim lirues, megjithatë duke patur mënyrën se si është arrestuar babi dhe mënyra se si është zhvilluar procesi në atë gjykatë, në mënyrë aq të padrejtë, kmi qenë duke pritur një vendim që do t'i shpallte fajtor. As që e kishim paramenduar një dënim kaq të madh. Duke pasur parasysh komandantë aq të mëdhenj të Serbisë që kanë bërë krime dhe gjenocide në Ballkan, kanë marrë dënime shumë herë më të ulëta.

Është një e vërtetë e pamohueshme që Gjykata Speciale është formuar në parlamentin e Kosovës, por në fakt është gatuar në Beograd dhe me mbështetësit e tyre. Mendoj se këtu vjen natyrshëm shpjegimi pse u dha një dënim mizor dhe kaq i madh për krerët e UÇK-së.

Në kohën kur është votuar Gjykata Speciale, babi nuk ka qenë fare pjesë aktive e politikës, pavarësisht disa videove që qarkullojnë në rrjetet sociale dhe kanë më tepër qëllim propagandistik. Mbaj mend që në atë periudhë, ndër zërat që e kanë kundërshtuar vendimin për Gjykatën Speciale ka qenë vetë babi. Mendoj se themelimi i saj ka qenë i domosdoshëm.

Ai ka qenë absolutisht kundër. Dje po bisedonim në Zoom dhe na tha se një ndër arsytet pse mori një dënim kaq të madh ishte sepse ishte kundër themelimit të kësaj Gjykate. Babi nuk ka qenë fare pjesë aktive e politikës kur është themeluar Gjykata Speciale.

Është njeri i jashtëzakonshëm, sepse një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë krenari, atë buzëqeshje, atë qëndrim, pavarësisht një jete të mbushur me sakrifica.

Mesazhi që na dha familjarëve ishte që s'i ka bërë asnjë njeriu keq. Unë dua që ju të jeni rehat, siç jam edhe unë. Unë kam luftuar për vendimin tim dhe dënimin e kam marrë prej akuzave të Serbisë.

Kur u hap kamera dhe pamë babin, ai ishte shumë i buzëqeshur. Sa i fortë duhet të jesh të kesh atë krenari dhe të mos e ndjesh peshën e atij dënimi? Ne jemi të dërmuar, por s'ja lejojmë vetes të jemi të thyer, sepse kemi përballë një luftë që s'ka mbaruar ende", tha ndër të tjera Gresa Krasniqi.

Top Channel

Kryesore



LIVE/ Deputetët në seancë plenare. Përshkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

12:30

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

10:23

Kuvendi nis me dënimin e Hagës për liderët e UÇK-së, Peleshi: Një vendim i dhimbshëm jo vetëm për Kosovën, por edhe për historinë tonë

10:41

Zgjedhjet në Rusi pa surpriza të mëdha, por Kremlin kërkon një sinjal të fortë për Putinin

09:32

Brajan Gruda merr zyrtarisht ftesën nga Gjermania e Klopp, por nuk do të luajë menjëherë

11:10

Më të lexuarat

E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime" / Vendimi për liderët e UÇK-së, avokatja përlotet në 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

Dënim i ish-krerëve të UÇK, Paskal Milo: Specialja u ngrit nën presionin e SHBA dhe BE, vendimi i sotëm është rrjedhojë e një kalkulimi gjeopolitik për të afruar Serbinë me Perëndimin

Gjykata e Hagës dënoi me 25 vite burg Hashim Thaçin, reagon djali i ish-liderit të UÇK: Ne e dimë historinë, ushtarët tanë e kanë të gdhendur në lëkurë

Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

Publikohen fotot e dëmeve nga sulmet iraniane në bazat amerikane, avionë të

I Kosova dhe Rajoni »



"Çfarë roli kishte Hashim Thaçi në UÇK?" / Ish-ushtari kujton tmerret e regjimit serb: Tortura shtazarake, ata që kanë mbijetuar kanë pasojë të rënda

17/09 14:12



"Ata kanë luftuar për lirinë tonë, kjo është padrejtësi" / Kunata e Jakup Krasniqit në lot pas vendimit të Hagës: Në vend që të ishte në shtëpi...

17/09 13:28



Vendimi i Speciales për Thaçin, eksperti: Jo vetëm me ligj, kundërshtohet edhe me fakte

17/09 13:27




Dënimet vihen në pikëpyetje/ Gazeta FAZ ngre pikëpyetje për proporcionalitetin e dënimeve ndaj ish-krerëve të UÇK-së

17/09 13:21



"Më tha se nuk i ka bërë keq askujt" / Mesazhi i Jakup Krasniqit për familjen, bashkëshortja flet për Top Channel: Avokatët do bëjnë apelin, por...

17/09 12:24



Exclusive/ Poezi imagjinare me nënën, si Jakup Krasniqi i jepte vetes zemër në paraburgim

17/09 11:39

I Kryesore »



Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

17/09 14:16



"Gjyshi i saj një vrasës serial, i ka marrë jetën shumë njerëzve të pafajshëm" / Akuzat e reja të SPAK për Ballukun, Berisha: Po tregon që është mbesa e Beqir Ballukut

17/09 14:13



"Situata në sistemin e shëndetësisë është e rënduar" / Interpelanca me ministren e Shëndetësisë, Spahiu i përgjigjet deputetit demokrat: Do më keni çdo javë përballë jush

17/09 13:45



"Ata kanë luftuar për lirinë tonë, kjo është padrejtësi" / Kunata e Jakup Krasniqit në lot pas vendimit të Hagës: Në vend që të ishte në shtëpi...

17/09 13:28



Dënimet vihen në pikëpyetje/ Gazeta FAZ ngre pikëpyetje për proporcionalitetin e dënimeve ndaj ish-krerëve të UÇK-së

17/09 13:21



Gjykata e Tiranës liron protestuesit e shoqëruar në komisariat: Arrestimi i tyre, i paligjshëm

17/09 12:59

Na ndiqni:



I Video »



dëmtuar dhe infrastrukturë e shkatërruar në Lindjen e Mesme

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

LIVE/ Deputetët në seancë plenare. Përshkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt

Top Channel/ "Një njeri i zakonshëm s'mund ta ketë atë buzëqeshje"/ Përlotet vajza e Jakup Krasniqit



Top Channel/ Theu masën 'arrest në shtëpi', arrestohet autori i 16 vjedhjeve në Tiranë

Top Channel/ Kunata e Jakup Krasniqit në lot pas vendimit të Hagës: Në vend që të ishte në shtëpi...



Top News – 'Jeni ushtarë të Yeffet'. Berisha akuzon PS pas rrezimit të hetimit për KAYO-n

Top News – 'Plaket' tregu i punës. Një në dhjetë të punësuar është mbi 64 vjeç



Top News- Shqiptarë e serbë, 'sherr' për indianët/ Ironia në Instagram: Ejani në Tiranë e Serbi

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tani!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.